



Pyetjet më të shpeshta në rast kompensimi të depozitave

Pyetje: Kush do të kompensojë depozitat e mia në bankën e falimentuar?

Përgjigje: Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD) është institucioni i cili në bazë të ligjit Nr. 53/2014, datë 22 Maj 2014 “Për Sigurimin e Depozitave” do të realizojë procesin e kompensimit të depozitave të depozituesve të bankës së falimentuar. ASD-ja do të kompensojë depozitat e sigurueshme të çdo depozituesi në bankë, shumën e depozituar/depozitës, por në çdo rast jo më shumë se 2,500,000 lekë për çdo depozitues, për çdo bankë, pavarësisht numrit të depozitave apo llojit të monedhës së tyre të depozituara në këtë bankë.

Pyetje: A duhet të paguaj unë për kompensimin e depozitës sime në bankën e falimentuar?

Përgjigje: Depozituesit nuk paguajnë për sigurimin dhe kompensimin e depozitave të tyre.

Ndër vite, Bankat (anëtare të skemës së sigurimit të depozitave) i kanë paguar ASD-së prim sigurimi për depozituesit e tyre, te cilët tashmë do të kompensohen nga ASD-ja deri në nivelin e mbulimit të përcaktuar sipas ligjit “Për sigurimin e depozitave”, dmth deri në nivelin maksimal prej 2.500.000 lekë në bankë.

Pyetje: Si mund të marr më shumë informacion për zhvillimin e procesit të kompensimit?

Përgjigje: ASD-ja informon depozituesit dhe publikun nëpërmjet kanaleve të saj të komunikimit të cilat janë: faqja zyrtare e internetit të ASD-së www.asd.gov.al; njoftimet zyrtare në median vizive dhe të shkruar; profili zyrtar në platformën facebook të ASD-së; numrat e telefonit në dispozicion + 355 4 2326 989/ + 355 4 2326 989; lajmërimet zyrtare të vendosura në degët e bankave; takime direkte me personat e autorizuar në ambjentet e Agjencisë. Gjithashtu mund të informoheni edhe në ambjentet e bankës agjente ose/dhe duke konsultuar njoftimeve në ëeb-in e bankës agjente.

Pyetje: Si mund të kontaktoj me dikë në ASD?

Përgjigje: Gjatë gjithë periudhës së procesit të kompensimit, për t’ju shërbyer sa më mirë, do të publikohen Njoftime të ndryshme, të cilat Ju bëjnë me dije që janë vendosur në dispozicionin tuaj disa kanale komunikimi, nëpërmjet të cilave mund t’ju jepet gjithë informacioni i nevojshëm.



Gjithashtu duke konsultuar faqen www.asd.gov.al në rubrikën “Na kontaktoni”, ju mund të përzgjidhni mënyrën më të përshtatshme për të kontaktuar Agjencinë si nëpërmjet numrave të telefonit të agjencisë, call center-it , e-mail-it zyrtar ose në adresën postare.

Numri i telefonit të Agjencisë + 355 42 362 989 është në shërbim nga ora 8.00-16.30; adresa postare Rruga e Elbasanit, nr.317, adresa e postës elektronike: info@asd.gov.al.

Pyetje: Nëse unë kam llogari jo vetëm në lekë por edhe në valutë, si do të kompensohem?

Përgjigje: Depozituesit që kanë depozita në monedhë të huaj do të kompensohen në lekë. Shuma e depozitës në valutë do të konvertohet në lekë sipas kursit zyrtar të këmbimit të monedhës të BSH të shpallur në datën e ndërhyrjes në bankë dmth më datë 05/12/2022 dhe do të kompensoheni me ekuivalentin në lekë. Depozitat në lekë dhe në valutë (të konvertuar) do të mbliidhen dhe depozitori do të kompensohet deri në nivelin e mbulimit 2.500.000 lekë. Kursin e këmbimit të valutës mund ta gjeni edhe në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë www.bankofalbania.org

Pyetje: A ka përjashtime nga skema e sigurimit të depozitave?

Përgjigje: Depozitat e përjashtuara nga sigurimi dhe kompensimi janë:

- pjesa e depozitës në bankë me vlerë mbi 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë ose shuma e barasvlershme me të (kundërvlerën), në monedhë të huaj;
- depozitat e bankës, degës së bankës, degës së bankës së huaj në emër dhe për llogari të vet, si dhe çdo subjekt tjetër financiar i licencuar nga Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
- depozitat e drejtorit, administratorit në bankë dhe familjarëve të tyre, sipas çertifikatës së gjendjes familjare;
- depozitat e çdo personi që zotëron 5 për qind ose më shumë në kapitalin e subjektit anëtar ose të aksioneve me të drejtë vote në këtë subjekt;
- depozitat e prejardhura nga veprimtari të lidhura me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, të cilat janë deklaruar të paligjshme me vendim gjykate të formës së prerë;
- depozitat e shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, vendase ose të huaja;
- depozitat e subjekteve të sipërmarrjes ose investimeve kolektive, vendase ose të huaja;
- depozitat e fondeve të pensionit ose sigurimit pensional, vendase ose të huaja;
- tituj të emetuar nga subjekte financiare dhe çdo lloj detyrimi tjetër që këto subjekte kanë bazuar mbi marrëveshjet e tyre të premtimit;
- depozitat e njëjësive të pushtetit qendror ose vendor, si dhe çdo enti publik të Republikës së Shqipërisë ose të një vendi të huaj;
- depozitat të paemërtuara dhe/ose titulli i të cilave nuk përcaktohet qartë;
- depozitat e vendosura në subjektin anëtar të skemës së sigurimit të depozitave gjatë dhe pas ditës së ngjarjes së sigurimit në këtë subjekt;



- depozitat e personave juridik, përveç atyre të përcaktuara në pikën 17, të nenit 3, të ligjit Për Sigurimin e Depozitave.

Pyetje: Si do të identifikohem unë si depozituesi real nëse edhe një ose me shumë persona kanë emrin dhe mbiemrin tim?

Përgjigje: Për qëllim të identifikimit unik është shumë e rëndësishme që Ju si depozitues, përveç dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, pasaportë), të dispononi kontratën e depozitës ose çdo dokument tjetër që vërteton pronësinë mbi depozitën.

Pyetje: Nëse unë nuk jam i pranishëm në Shqipëri përgjatë periudhës që kryhet kompensimi i depozitave në bankën në të cilën kam depozituar kursimet e mia, si duhet të veprojmë për të marrë kompensimin deri në nivelin e përcaktuar në ligj?

Përgjigje: Në përputhje me dispozitat e ligjit Për Sigurimin e Depozitave, afati kohor brenda të cilit depozituesit mund të paraqesin pretendimet e tyre pranë Agjencisë është 10 vjet. Me përfundimin e afatit ligjor të procesit të kompensimit, fondi i mbetur i kompensimit për depozitat e siguruar, (i përbërë nga shumat e kompensimit që mbeten të pashlyera deri në përfundim të këtij afati), transferohen prej Agjencisë në një llogari të veçantë pranë Autoritetit Mbikëqyrës.

Pyetje: A ka ndonjë mundësi që ASD nuk është në gjendje të paguajë të gjitha depozitat e garantuara të bankës së falimentuar? Si vepron ASD për të siguruar fonde për rimbursimin e garantuar të depozitave?

Përgjigje: Agjencia do të përmbushë të gjitha detyrimet ndaj depozituesve. Agjencia ndër vite ka krijuar një fond të caktuar për të paguar depozituesit e bankës dhe do e përdori fondin për kompensimin e depozitave në këtë rast. Gjithashtu, Agjencia hyn në marrëveshje me institucione financiare ndërkombëtare që mundësojnë fonde shtesë në rast kompensimi të depozituesve. Nëse nevojiten fonde të tjera, Agjencia i siguron ato nga Buxheti i Shtetit në formën e huasë, subvencionit ose rritjes së fondit themeltar.

Pyetje: Nëse një fëmijë ka një llogari kursimi menaxhuar nga një prind/prindërit, cili duhet të paraqitet në sportel? Prindi vetëm apo shoqëruar me fëmijën ?

Përgjigje: Kur Titullari i depozitës është një i mitur, depozita është në pronësi të tij dhe sigurohet në emër të tij dhe jo të prindit që administron llogarinë. Por për efekt kompensimi, pagesa e shumës për kompensim për të miturin, kryhet nëpërmjet prindit, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të tyre. Kështuqë në sportel duhet të paraqitet prindi.

Pyetje: Cilat institucione janë anëtarë të skemës së sigurimit të depozitave?

Përgjigje: Anëtarë të skemës së sigurimit të depozitave janë bankat e nivelit të dytë që kryejnë aktivitetin e tyre në Republikën e Shqipërisë dhe shoqëritë e kursim kreditit.



Pyetje: Për sa kohë do të kryhet procesi i kompensimit?

Përgjigje: Procesi i kompensimit do të zgjasë 3 muaj. Ai ka filluar më datë 05/12/2022 dhe do të përfundojë më datë 05/03/2023

Pyetje: Niveli i kompensimit/mbulimit është për person apo për llogari, për çdo bankë më vete apo për gjithë bankat në sistem?

Përgjigje: ASD do të kompensojë depozitat e sigurueshme të çdo depozituesi: a) në çdo bankë në masën 100 për qind, por në çdo rast jo më shumë se 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë, pavarësisht numrit të depozitave apo llojit të monedhës të tyre, të depozituara në këtë bankë. ASD-ja siguron si depozitat me afat ashtu edhe depozitat pa afat të individëve, si dhe llogaritë rrjedhëse dhe llogaritë e kursimit. Në këto llogari përfshihen llogari page, llogari pensioni, llogari ndihme ekonomike.

Pyetje: Kompensimi i shumës së depozitës sime do të kryhet sipas nivelit të përcaktuar në Ligjin “Për Sigurimin e Depozitave” të Shqipërisë apo juridiksionit të shtetit të origjinës së bankës mëmë ?

Përgjigje: Kompensimi do të kryhet në bazë të juridiksionit shqiptar, dmth kritereve të përcaktuara në Ligjin “Për sigurimin e depozitave”, ligj që vepron në Republikën e Shqipërisë.

Pyetje: Nëse Unë kam në bankë llogari rrjedhëse (dmth pagën që më paguan institucioni) dhe nuk kam kontratë, sepse kontratën me bankën tashmë të falimentuar e ka lidhur institucioni, si duhet të veproj? Çfarë dokumenti duhet të paraqes në sportelin e bankës?

Përgjigje: Ju duhet të paraqiteni në sportel me kartën e identitetit dhe numrin e llogarisë suaj në këtë bankë.

Pyetje: Nëse Unë kam x lekë depozitë dhe y lekë kredi, a do të kompensohem për depozitën? Çfarë bëhet me shumën e lekëve që duhet të paguaj në vite si këste për kredinë e marrë.

Përgjigje: Në përputhje me dispozitat e ligjit për sigurimin e depozitave, depozituesi do të kompensohet për depozitën e tij edhe nëse ka kredi, por nëse në ditën e vënies së subjektit anëtar të skemës në likuidim rezulton që depozituesi ka detyrime të papaguara në kohë ndaj subjektit, këto detyrime do të zbriten nga shuma që përfiton depozituesi nga kompensimi.